



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. **613** Prot.

Tiranë, më 04. 05. 2018

V E N D I M

Nr. 116, Datë 04. 05. 2018

Mbështetur në ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 146 rregj., datë 08.11.2017, e Komitetit Shqiptar të Helsinkit, si përfaqësues¹ ligjor i shtetasve: M. V., D. H. dhe P. H., kundër Bashkisë Lezhë, me pretendim diskriminimin për shkak të gjendjes ekonomike dhe sociale.

Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

Në ankesën e parashktruar, ankuesit sqarojnë se: “*Jemi pjestar të një komuniteti prej 15 familjesh që jetojmë në gjendje të vështirë ekonomike dhe sociale, si dhe në kushte të rënda jetese në ish kampin e Torovicës, Njësia Balldre, Bashkia Lezhë. Godina në të cilën jemi vendosur është në pronësi të shtetit dhe për pasojë nuk disponojmë dokumente që mund të legjitimojë qëndrimin tonë në këtë godinë. Pavarësisht kësaj, shpesh herë jemi vendosur në kushtet për të paguar shumën të caktuara personave të tjerë të cilët qëndronin më parë në këto ambiente të ish kampit, me qëllim që të mos çënohej e drejta e qëndrimit të familjeve tona në hapsirat e përshtatura. Kushtet infrastrukturore të godinës së ish kampit të Torovicës janë mjaft të vështira. Xhamat e dritareve janë të thyera dhe të përshtatur me plastmasë për moslejimin e agjentëve atmosferikë jashtëm, dyert janë të amortizuara, ka prezencë të lagështirës në mure, ajri përreth është i ndotur, etj. Rruga automobilistike që lidhet me ish kampin e Torovicës nuk është në kushte të përshtatshme infrastrukturore. Mbetjet urbane të 15 familjeve mbledhen pranë banesave dhe qëndrojnë aty deri në dy javë, çka përbën rrezik për ndotjen e ambientit dhe shëndetit tonë e të familjarëve tanë. Komuniteti i banorëve të vendosur në ish kampin e Torovicës jeton në kushte të rënduara social ekonomike. Një pjesë e jona angazhohet në punë sezonale ose në shitjen e produkteve bimore, për këto të ardhura nuk mund të na sigurojnë një jetesë minimale. Gjithashtu vuajmë mungesën e ujit të pijshëm. Disa prej nesh përdorin ujin e pusit të një banori kundrejt një pagese të vendosur prej tij, për nevoja të ndryshme të jetesës. Nërsa uji i pijshëm mundësohet nëpërmjet një automjeti*

¹ Me Prokurë të Përgjithshme Nr. 1901 Rep., datë 26.07.2017

privat, i cili i mbush enët e ujit në qytetin e Lezhës, kundrejtë një pagese minimale. Nga informacionet e marra nga KSHH me përfaqësues të Bashkisë Lezhë, rezultoi se janë rreth 30 banesa sociale që administrohen nga autoritetet vendore, nga të cilat kanë përfitur anëtarë të komunitetit rom dhe asnjë prej familjeve që jeton në ambientin e ish kampit të Torovicës. Gjendja në të cilën ndodhemi prej shumë kohësh edhe me dijeninë e Bashkisë Lezhë dhe institucioneve të tjera të varësisë, nuk ka ndryshuar pavarësisht të drejtës për të përfitur nga shërbimet publike të organeve të njësive të qeverisjes vendore, në territorin e së cilës banojmë. Së pari, gjendja aktuale e amortizuar infrastrukturore, e cila vazhdon prej vitesh, ka vështirësuar komunikimin dhe lëvizjen tonë dhe te banorëve të ish kampit të Torovicës, duke i vendosur në kushte të pabarabarta me shtetasit e tjerë që nuk banojnë në këtë ambient, sa i përket aksesit në përfitim të shërbimeve publike. Kjo situatë është tregues i pasojave që ka sjellë pasiviteti i organeve publike, veçanërisht i Bashkisë Lezhë. Së dyti, mungesa e ujit të pijshëm përbën një shkelje të së drejtës për jetë të qetë familjare tonën dhe të banorëve të tjerë në ambientin e ish kampit të Torovicës. Për shkak të rëndësisë që ka e drejta për ujë, në nivel ndërkombëtar janë miratuar dhe janë ngritur një sërë mekanizmesh që monitorojnë respektimin e kësaj të drejte në praktikë. E drejta për ujë nuk nënkupton që uji të ofrohet pa pagesë, por që ai të jetë fizikisht dhe ekonomikisht i aksesueshëm, i mjaftueshëm, i sigurtë, i pranueshëm, për përdorim personal dhe shtëpiak...”

Diskriminimi për shkak të gjendjes ekonomike dhe sociale, janë shkaqe të mbrojtura nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, në nenin 3/1, parashikohet se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasoje pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10221/2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ndërmori hapat proceduralë si më poshtë vijnë :

Pas analizimit të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vijoi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Mbështetur në nenin 33, pika 5 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, me anë të shkresës nr. 1135 prot., datë 21.11.2017, Komisioneri për Mbrojtjen

nga Diskriminimi, iu drejtua Bashkisë Lezhë, në të cilën kërkoi informacion mbi pretendimet e subjektit ankues.

- Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, pavarësisht se ka marrë dijeni mbi njoftimin e Komisionerit, Bashkia Lezhë nuk vuri në dispozicion asnjë informacion.

2. Duke qënë se Bashkia Lezhë nuk vuri në dispozicion asnjë informacion, lidhur me kërkesat e KMD-së dhe mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", për shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vendosi të realizojë një seancë dëgjimore mes palëve.

Sipas njoftimeve të realizuara nga KMD me anë të shkresës nr. 137 prot., datë 23.01.2018, në seancën dëgjimore të zhvilluar më datë 31.01.2018, ishin prezent përfaqësues të Bashkisë Lezhë: A. M., me detyrë N/Kryetare dhe N. V., me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike, si dhe E. F., përfaqësues i Komitetit Shqiptar i Helsinkit.

Fillimisht mbështetur në kërkesat e parashtruara nga KMD, përfaqësuesit e Bashkisë Lezhë, sqaruan se, kushtet e jetesës, mungesa e infrastrukturës rrugore, mungesa e ujit të pijshëm dhe gjendja ekonomike e rënduar, janë problematika me të cilat Institucioni i Bashkisë Lezhë është i njohur.

- Përsa i përket gjendjes ekonomike të tre familjeve të subjekteve ankues, përfaqësuesit e Bashkisë informuan se: *"...familja e shtetasit D. H., si familje në nevojë dhe e kthyer nga emigracioni në Gjermani, është trajtuar për 6-muaj nga Bashkisë në bashkëpunim me Organizatën Terre des Hommes, me paketa ushqimore, pajisje shtëpiake, si dhe dy bagëti të imta. Gjithashtu trajtohet me ndihmë ekonomike në masën 5300 lekë dhe kompensim të energjisë elektrike në masën 1288 lekë/muaj. Përsa i përket familjes së ankuses M. V., nuk rezulton të ketë aplikuar pranë zyrave të Ndihmës Ekonomike pranë Njësisë Administrative Balldre, por rezulton që ankuesja është trajtuar me tokë bazuar në ligjin nr. 7501 "Për tokën" dhe disponon 14553 m². Lidhur me familjen e shtetasit Preng Lleshi, rezulton që trajtohet me ndihmë ekonomike nga ana e Bashkisë në masën 8788 lekë/muaj"*
- Lidhur me infrastrukturën rrugore, u sqarua se Bashkia Lezhë, pavarësisht faktit që nuk i ka nën administrim rrugët kombëtare (pasi janë nën administrimin e Autoritetit Rrugor Shqipëtar), ka hartuar projektin për *"Përmirësimin e infrastrukturës ndërlidhëse, ndërmjet Qarkut Shkodër dhe Qarkut Lezhë, nëpërmjet rikonstruksionit të aksit Ura e Gjo Lulit-Torovicë-Balldren"*, për të cilin ka aplikuar gjatë vitit 2015 dhe 2017 pranë Fondit Shqipëtar të Zhvillimit dhe gjatë viteve 2016-2017, tek Fondi i Zhvillimit të Rajoneve, por asnjë prej tyre nuk është miratuar.

- Përsa i përket ujit të pijshëm, u sqarua se në këtë zonë nuk ka patur asnjëherë dhe teknikisht është e pamundur të furnizohet me ujë të pijshëm nga ana e Bashkisë Lezhë. Mënyra e vetme e furnizimit me ujë të pijshëm janë pusët apo çpimi i tokës.
- Gjithashtu, Bashkia Lezhë nuk mund të ndërhynte në rikonstruksionin e ambjenteve të banimit për shkak të mungesës së fondeve dhe dokumentacionit mbi pronësinë e vendbanimeve.
- Lidhur me mbetjet urbane, u sqarua se në muajin dhjetor të vitit 2016 është miratuar nga Bashkia, Plani i Integruar i Mbetjeve, ku zona e Torovicës është pjesë e këtij plani. Ka patur vonesa implementimin e këtij plani për shkak të disa problematikave në prokurim, por që gjatë vitit 2017 janë zgjidhur.

3. Referuar diskutimeve të zhvilluara gjatë seancës dëgjimore të datës 31.01.2018, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me anë të shkresës nr. 249 prot., datë 13.02.2018, kërkoi nga ana e Bashkisë Lezhë të paraqesë parashtrime me shkrim dhe të vërë në dispozicion:

- Informacion nëse Bashkia Lezhë, ka hartuar ndonjë Plan apo Projekt për furnizimin me ujë të pijshëm, për pastrimin e mbetjeve urbane, përmirësimin e infrastrukturës rrugore dhe për ndërhyrjen dhe përmirësimin e kushteve të banesave të banorëve të ish kampit të Torovicës.
- Informacion nëse Bashkia Lezhë është vënë në dijeni të çështjeve të ngritura nga banorët e ish kampit të Torovicës dhe masat që ka marrë për zgjidhjen e këtyre problematikave.
- Informacion nëse ankuesit kanë aplikuar për një nga programet e strehimit pranë Bashkisë Lezhë.

Në përgjigje të kërkesave të sipërcituara, me anë të shkresës² nr. 680/3 prot., datë 26.02.2018 Bashkia Lezhë informoi se: *“1. Bashkia Lezhë po planifikon hapjen e një pusi të ri me qëllim furnizimin me ujë sa më sanitar të banorëve të ish-kampit të burgosurve Torovicë. Sipas informacionit të dhënë Njësia Administrative Balldre, disa vite më parë është hapur një pus pranë ish-kampit të burgosurve Torovicë, por ka rezultuar që nuk ka qënë i pijshëm.*

2. Për pastrimin e mbetjeve ndodhen kontenier të vendosur në distancë prej rreth 300 m (në qendër të Marlecaj) nga ish-Kampi i Torovicës, sipas Planit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Urbane 2017-2021 të Bashkisë Lezhë.

3. Përsa i përket infrastrukturës rrugore, ju bëjmë me dije se, rruga është asfaltuar deri në qendër të fshatit Marlecaj, pjesë e të cilit është ish-kampi i Torovicës, ndërsa pjesa e rrugës që lidh qendrën e fshatit Marlecaj me ish-kampin me një distancë prej 500 m, në mungesë të mundësive financiare për ta asfaltuar, do të mirmbahet me shtresa cakulli nga Drejtoria e Shërbimeve Publike. Gjithashtu Bashkia Lezhë, ka planifikuar që në bashkëpunim me Fondin Shqiptar të

² Protokolluar pranë KMD-së me nr. 249/1 prot., datë 28.02.2018

Zhvillimit të realizojë rikonstrukcionin e rrugës Balldre-Torovicë-Bent, e cila do të përmirësonte jetën e banorëve të zonës, përfshirë edhe banorët e ish-kampit.

4. Përsa i përket banesave, mbi bazën e verifikimit të bërë në njësinë administrative Balldre, nuk rezultoi që objektet e ish-kampit të të burgosurve të Torovicës, të ketë kaluar me VKM në pronësi të ish-komunës Balldre, sot Bashkia Lezhë.

Në këto kushte, Bashkia Lezhë në aspektin ligjor, nuk mund të ndërhyjë me investim, për përmirësimin e kushteve të banimit, mbi këto ndërtesa, duke qënë se nuk i ka prona të saj. Ankuesit nuk kanë paraqitur kërkesë para Bashkisë Lezhë për tu pajisur me statusin e të pastrehit si dhe për mundësinë e privatizimit nga ana e tyre. Ndërtesat e ish-kampit, që pas viteve 1991 kanë qënë të pabanueshme. Në asnjë kohë nuk ka pasur ujësjellës për ujë të pijshëm, nuk ka asnjë burim që të mbajë ujë të pijshëm. Edhe në kohën kur ka funksionuar burgu, furnizimi me ujë të pijshëm është bërë nëpërmjet autoboteve.”

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Në përfundim të procedurave të shqyrtimit të ankesës dhe bazuar në dokumentacionin e administruar, Komisioneri vëren se:

Gëzimi i të drejtave të njeriut në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim garantohet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Neni 18 i Kushtetutës së RSH-së³ sanksionon se të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. Kreu i IV i Kushtetutës vë theksin tek liritë dhe të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, të cilat duhet të gëzohen de facto, në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim.

Në proceset e aderimit në institucionet ndërkombëtare, Shqipëria ka nënshkruar një sërë aktesh ndërkombëtare, ndër të cilat është edhe Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, e cila jo vetëm që është pjesë e e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, por zë një vend të veçantë brenda tij. Konventa njeh dhe parashikon kufizime të përgjithshme dhe kufizime specifike për të drejta të veçanta. Neni 14 i Konventës garanton barazinë “në gëzimin e të drejtave dhe lirive” të përcaktuara në të. Protokollin 12 i saj ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu është më i zgjeruar fushëveprimin e tij sesa Neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.⁴

Shkaqet e origjinës sociale, lindjes dhe pronës paraqiten gjithashtu në Nenin 2(2) të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore e vitit 1966. Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, përgjegjës për monitorimin dhe interpretimin e traktatit e ka zgjeruar kuptimin e tyre në Komentin e tij të Përgjithshëm 20.

³ Ligji nr.8417, datë 21.10.1998, i ndryshuar.

⁴ https://www.echr.coe.int/Documents/Handbook_non_discrim_law_SQL.pdf , faqet 47 dhe 49

Paktit Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore⁵, për shtetet palë parashikon detyrimin për të njohur të drejtën e secilit për një standard të përshtatshëm të jetesës për vete dhe për familjen e tij, duke përfshirë ndër të tjera dhe ushqimin

Ligji Nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, neni 1 sipërcituar dhe neni 3/1, parashikojnë se: “*Diskriminim*” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.

Nenet 3, 9, 23 dhe 24 të ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në mënyrë të përmblodhur parashikojnë se vetëqeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë, si dhe realizimit të shërbimeve në përputhje me standardet e kërkuara në ligj ose akte të tjera normative, nëpërmjet mirëmbajtjes së rrugëve vendore, mbledhjes dhe largimit të mbetjeve urbane, si dhe përgjegjëse për furnizimin me ujë të pijshëm, krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, ndërtimin e banesave për strehim social, etj.

I. Lidhur me pretendimin e ankuesve për trajtim të pabarabartë dhe të disfavorshëm nga Bashkia Lezhë, për shkak të gjendjes ekonomike dhe sociale.

Nga informacioni i administruar gjatë procedurave hetimore rezulton se, banorët e ish-kampit të të burgosurve Torovicë, janë vendosur në ato ndërtesa pas vitit 1991. Që nga ajo kohë e në vazhdim ky komunitet është përballur me vështirësi ekonomike, mungesë të ujit të pijshëm, grumbullim të mbetjeve urbane për shkak të mungesës së kontenieneve të vendosur nga ana e njësisë vendore, infrastrukturë rrugore të amortizuar dhe gjendje të amortizuar të ambjenteve të banimit.

Së pari, prej vitesh, gjendja e infrastrukturës rrugore që lidh Torovicën me aksin rrugor Lezhë-Shkodër, është tejet e amortizuar dhe nuk është kryer asnjë investim. Nga ana e Bashkisë Lezhë në vitin 2016 dhe 2017, janë dërguar pranë Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Fondit të Zhvillimit të Rajoneve, mes të tjerash edhe projekti për asfaltimin e rrugës Balldre-Torovicë-Bent, me një vlerë 657,108, 372 lekë, por që ende nuk është marrë një miratim nga ana e këtyre institucioneve. Segmenti rrugor prej 500 m, që lidh qendrën e fshatit Marlecaj me ish-kampin e Torovicës, ka nisur të mirëmbahet nga ana e Drejtorisë së Shërbimeve Publike të Bashkisë Lezhë.

⁵ Aderuar me ligjin nr. 7511/1991 “Për aderimin në Paktin Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore”

Mbështetur në provat e administruara gjatë procedurave hetimore, Bashkia Lezhë ka marrë masa duke hartuar së fundmi gjatë viteve 2016-2017, projektin për përmirësimin e infrastrukturës rrugore që lidh segmentin kombëtar nga qendra e fshatit Balldre me Torovicën, pjesë e rrugës që prek jo vetëm banorët e ish-kampit, por të gjithë komunitetin e Torovicës.

Autoriteti Rrugor Shqiptar (A.Rr.Sh.) u krijua me Ligjin Nr.10164, date 15/10/2009, “Për autoritetin rrugor shqiptar”. Qëllimi i Ligjit ishte krijimi i Autoritetit Rrugor Shqiptar me kompetencat, përgjegjësite dhe detyrat e tij. Funkzioni i ARSH është të përgatisë dhe zbatojë masa të administrimit të rrjetit rrugor shtetëror, me theks të vecantë mbi interesin publik në përputhje me Kodin Rrugor dhe Ligjin “Për Autoritetin Rrugor Shqiptar”. Autoriteti, nëse do të konsiderohet e domosdoshme, mund të permbushë funksionet e tij në bashkëpunim me institucionet e tjera pjesëmarrëse në sektorin e transportit publik rrugor.⁶

Mbështetur në përcaktimet në nenin 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 10164/2009, “Për autoritetin rrugor shqiptar”, fusha e veprimtarisë së Autoritetit Rrugor është menaxhimi i rrjetit rrugor shtetëror, në përputhje me dispozitat e Kodit Rrugor dhe të këtij ligji, krijon dhe mirëmban sistemin për administrimin e rrugëve shtetërore dhe të urave.

Gjithashtu, referuar informacionit⁷ të administruar në faqen web të Autoritetit Rrugor Shqiptar, segmenti rrugor Balldre-Torovicë, rezulton të jetë nën administrimin e Autoritetit Rrugor Shqiptar.

Ndërsa, duke iu referuar nenit 23, pika 4, të ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ku përcaktohen funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, vërejmë se bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore.

Në këto kushte, vërehet se njësitë e qeverisjes vendore, nuk kanë kompetencë në administrimin e rrjetit rrugor shqiptar. Në analizë të provave, fakteve të administruara dhe legjislacionit të sipërcituar, Bashkia Lezhë, si njësi vendore, është përgjegjëse në territorin nën juridiksionin e saj për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore. Mirëmbajtja me çakull e segmentit rrugor prej 500 m, që lidh qendrën e fshatit Marlecaj me ish-kampin e Torovicës, i jep një zgjidhje të përkohshme situatës në të cilën ndodhet kjo rrugë.

Së dyti, u konstatua se mungesa e ujit të pijshëm për banorët e ish kampit të Torovicë, është një tjetër problematikë e cila nuk ka gjetur zgjidhje nga ana e ish-Komunës Balldre, por edhe nga ana e Bashkisë Lezhë aktualisht. Banorët arrijnë të sigurojnë ujin e pijshëm nëpërmjet autoboteve të subjekteve private të cilët furnizojnë të gjithë banorët kundrejt një pagese. Gjithashtu, kundrejtë

⁶ Marrë në faqen: www.arrsh.gov.al/misioni-historiku.html

⁷ Marrë në faqen: <https://www.arrsh.gov.al/rrjeti-rrugor-kombetar.html>

pagesës nga ana e banorëve sigurohet edhe uji për përdorim të përditshëm (për higjenën personale dhe familjare, larjen e rrobave etj).

Në Nenin 11 dhe 12 të Paktit Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore⁸, parashikohet detyrimi i shteteve palë për të njohur të drejtën e secilit për një standard adekuat të jetesës për vete dhe për familjen e tij, duke përfshirë ndër të tjera dhe ushqimin. Masat që shtetet palë të këtij Pakti duhet të marrin për të arritur realizimin e plotë të kësaj të drejte duhet t'i përfshijnë ato masa që janë të nevojshme për të siguruar *përmirësimin e të gjitha aspekteve të higjenës së mjedisit dhe të higjenës industriale*.

Në referim të nenit 11 (1) të Paktit, shtetet palë *"njohin të drejtën e të gjithëve për një standard të përshtatshëm jetese për vete dhe familjen, duke përfshirë ushqim të përshtatshëm, veshje dhe strehim, si dhe përmirësim i vazhdueshëm të kushteve të jetesës "*.

Referuar rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara 64/292, datë 28 korrik 2010, në të cilën Asambleja njohu të drejtën për ujë të pijshëm të pastër dhe të sigurt dhe për kanalizime si një të drejtë të njeriut, e cila është thelbësore për gëzimin e plotë të jetës dhe të të gjitha të drejtave të njeriut, theksohet se uji i pastër dhe kanalizimet janë esenciale në realizimin e të gjitha të drejtave të njeriut. Kjo rezolutë shton trysninë mbi përgjegjësinë politike të shteteve për t'u garantuar qytetarëve të drejtën elementare për ujë të pijshëm.

Në çështjen Thlimmenos kundër Greqisë⁹, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ka mbajtur qëndrimin se: *".....kemi një diskriminim kur shteti pa një argumentim objektiv dhe racional e refuzon trajtimin e diferencuar të personave, situata e të cilëve është tepër e ndryshme....."*.

Në interpretim të çështjes së sipërcituar, GJEDNJ përcakton se Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e cila është pjesë e legjislacionit të brendshëm¹⁰ dhe jurisprudencës së Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në mbrojtjen nga diskriminimi përfshin jo vetëm detyrimin e trajtimit të barabartë të personave në situata të njëjta, por dhe trajtimin ndryshe të personave në situata të ndryshme.

Referuar nenit 23, pika 1, të ligjit Nr. 139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"*, ku përcaktohen funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, vërejmë se bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për: prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm.

⁸ Aderuar me ligjin nr. 7511/1991 "Për aderimin në Paktin Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore"

⁹ Thlimmenos kundër Greqisë, Kërkesa nr. 34369/97, vendimi me datë 06.04.2000.

¹⁰ Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin nr.8137, datë 31.07.1996, hyrë në fuqi në datë 02.08.1996) dhe jurisprudenca e GJEDNJ janë të detyrueshme për tu zbatuar bazuar në nenin 116 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Në këto kushte, referuar informacionit të administruar, Bashkia Lezhë nuk vuri në dispozicion të KMD-së asnjë informacion zyrtar, projekt apo plan, mbi masat që ka marrë ose që do të ndërmerret për furnizimin me ujë të pijshëm të banorëve të ish-kampit të të burgosurve Torovicë.

Së treti, grumbullimi i mbetjeve urbane pranë banesave të tyre është një tjetër problematikë që ka vijuar dhe vijon të jetë prezent. Nga informacioni i administruar, rezultoi që Bashkia Lezhë ka vënë në dispozicion të këtyre banorëve kontenierë për grumbullimin e mbetjeve urbane, por që janë të vendosur në një largësi prej 300 metra (në qendër të Marlecaj) nga ish-Kampi i Torovicës. Në këto kushte, banorët e ish-kampit të Torovicës përballen me vështirësi për të aksesuar kontenierët e vendosur nga ana e pushtetit lokal, pasi ndodhen në një distancë të konsiderueshme nga banesat e tyre.

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, në vendimin e marrë në çështjen *T tar kundër Rumanisë*¹¹, është shprehur se ndotja mund të çënojë jetën private dhe familjare të një personi ose mirëqenien e tij dhe shteti ka për detyrë të sigurojë mbrojtjen e qytetarëve duke rregulluar, autorizuar, ngritur, funksionimin e sigurisë dhe monitorimin e aktiviteteve industriale, veçanërisht aktivitetet që janë të rrezikshme për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

Pavarësisht faktit, që Bashkia Lezhë ka marrë masat për vendosjen e kontenierëve të mbetjeve urbane, ato janë në një largësi të konsiderueshme nga banesat e ankuesve për ti aksesuar, çka sjell si rezultat grumbullimin e mbetjeve pranë banesave të tyre, duke ndotur në këtë mënyrë mjedisin që i rrethon dhe duke rrezikuar shëndetin nga përhapja e sëmundjeve.

Së katërti, referuar informacionit dhe provave të administruara, ndërtesat e ish-kampit të Torovicës prej vitesh janë në një gjendje tejet të amortizuar kanë nevojë emergjente për rikonstruksionin e tyre. Që nga momenti që këto familje janë vendosur në këto ambiente, nga ana e pushtetit lokal nuk është bërë asnjë përpjekje për të marrë masa për gjetjen e një zgjidhje alternative për strehimin e tyre.

Në këtë kuadër, referuar informacionit të administruar, Bashkia Lezhë nuk vuri në dispozicion të KMD-së asnjë informacion zyrtar, projekt apo plan, mbi masat që ka marrë ose që do të ndërmerret për përmirësimin e kushteve të jetesës dhe gjetjen e një zgjidhje alternative, për stehimin në kushte sa më dinjitoze të banorëve të ish-kampit të të burgosurve Torovicë.

Së fundmi, sa i përket gjendjes së tyre ekonomike, Bashkia Lezhë mbështetur në mundësitë financiare që disponon dhe nëpërmjet projekteve me organizata jo qeveritare, ka marrë masa për të mbështetur ankuesit me ndihmë ekonomike, por edhe duke i mbështetur me paketa ushqimore, pajisje shtëpiake apo bagëti të imta.

¹¹ Çështja Nr. 67021/01, datë 27.01.2009

Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, në pikën 25 të Komentit të Përgjithshëm Nr. 20, është shprehur se: “*Statusi i pronës, si një bazë e ndaluar e diskriminimit, është një koncept i gjerë dhe përfshin pronën e patundshme (p.sh. pronësia ose zotërimi i tokës) dhe pasuria personale (p.sh. pronësia intelektuale, mallrat dhe sendet dhe të ardhurat), ose mungesa e saj. Komiteti ka komentuar se të drejtat e Konventës, si qasja në shërbimet e ujit dhe mbrojtja nga dëbimi i detyruar, nuk duhet të kushtëzohen me statusin e një personi mbi pronësinë ose zotërimin e tokës, siç është jetesa në një vendbanim informal.*”

Përsa më lartë, në analizë të fakteve¹² dhe provave të sipërcituara, kushtet e infrastrukturës rrugore, mungesa e ujit të pijshëm dhe mungesa e kontenierëve të grumbullimit të mbetjeve urbane, janë fakte të njohura prej kohësh, për të cilat Bashkia Lezhë nuk ka marrë asnjë masë për t’i dhënë zgjidhje kësaj situatë. Mos përmbushja e detyrimeve të sanksionuara në legjislacionin shqiptar, nga ana e Bashkisë Lezhë, vendos në pozita të pabarabarta ankuesit me banorë të tjerë të kësaj njësie administrative për të cilat janë marrë masa për përmirësimin e kushteve të jetesës.

II. Shkaku i diskriminimit i pretenduar nga ankuesit.

“*Gjendja ekonomike dhe sociale*” janë shkaqe, për të cilat Ligji nr.10 221, datë 4.2.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër*”.

Shkaqet e origjinës sociale, lindjes dhe pronës paraqiten në Nenin 2(2) të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore e vitit 1966. Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, përgjegjës për monitorimin dhe interpretimin e traktatit e ka zgjeruar kuptimin e tyre në Komentin e tij të Përgjithshëm 20. Sipas Komitetit, statuset e “origjinës sociale”, “lindjes” dhe “pronës” janë të lidhura. Origjina sociale “tregon statusin social të trashëguar të individit”. Mund të lidhet me pozitën që kanë përfituar me lindjen në një komunitet ose klasë shoqërore të caktuar (si p.sh. përkatësia etnike, besimi fetar, ose ideologjia), ose nga situata shoqërore si p.sh. varfëria ose të qenurit i pastrehë. Shkaku i pronës mund të lidhet me

¹² <https://www.youtube.com/watch?v=ZXNZ3yLnVIY>;
<https://www.youtube.com/watch?v=hWQAPHQDP1M>;
<https://www.youtube.com/watch?v=nsaSyNvAhf8>;

statusin e dikujt në lidhje me tokën (si të qenit një qiramarrës, pronar ose banues i paligjshëm), ose në lidhje me pronën e të tjerëve.¹³

Çështjet e diskriminimit kërkojnë që të vërtetohet nëse ekziston një përlligje e arsyeshme për trajtimin ndryshe të evidentuar.

Përsa i përket shkaqeve të pretenduara nga ankuesit, bazuar në informacionin e depozituar pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si dhe fakteve të bëra publike në media, konstatohet gjendja e rënduar ekonomiko-sociale e ankuesve, ndërsa nga ana e Bashkisë Lezhë, nuk është paraqitur asnjë provë, argument apo fakt i dokumentuar, që do të justifikojë mosmarrjen e masave për sigurimin e ujit të pijshëm, strehimit apo infrastrukturës rrugore.

Në përfundim, nisur nga shqyrtimi i këtyre fakteve, Komisioneri gjykon se, mosveprimet nga ana e Strukturave të Bashkisë Lezhë, në dëm të ankuesve, kanë sjellë për pasojë edhe vendosjen e tyre në kushte të disfavorshme, pa shkaqe të arsyeshme, duke i vënë në pozita diskriminuese për shkak të gjendjes ekonomike dhe sociale.

Në këtë kontekst, referuar nenit 7, pika 1¹⁴, të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nga analizimi në tërësi i fakteve të sipërpërmendura, gjykojmë se ankuesit, janë ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe diskriminues, nga ana e Strukturave të Bashkisë Lezhë, trajtim i cili ka lidhje të drejtpërdrejtë, me gjendjen ekonomiko-sociale të tyre.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 3, 4, 7, pika 1, nenin 12, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit, për shkak të gjendjes ekonomike dhe sociale, të subjekteve ankuese M. V., D. H. dhe P. H., nga ana e Bashkisë Lezhë.
2. Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, të merren masa të menjëherëshme nga ana e Bashkisë Lezhë, për sigurimin e ujit të pijshëm dhe kontenierëve të mbetjeve urbane, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga e marrja dijani për këtë vendim.

¹³ Marrë në https://www.echr.coe.int/Documents/Handbook_non_discr_i_law_ENG.pdf

¹⁴ Në nenin 7, pika 1, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashikohet: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.

3. Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, të merren masa të menjëherëshme nga ana e Bashkisë Lezhë, për gjetjen e zgjidhjeve alternative për strehim dhe përmirësimin e infrastrukturës rrugore, për banorët e ish-kampit të të burgosurve Torovicë.
4. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijani për këtë vendim, Bashkia Lezhë, të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.
5. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2011, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
6. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Gjendja ekonomike dhe sociale)

(Fusha: Të mira dhe shërbime)